



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:265774

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06524938

**AC-I-24-0544**

***Në ankesën e***

***Paditësi/Ankuesi***

**R A**, Prishtinë.

***kundër***

***E paditura***

**N.SH. Banka Themelore "BANKKOS" (në likuidim)**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtar, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-7495 të datës 11 qershor 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 nëntor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-7495 i datës 11 qershor 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me datë 15 dhjetor 2014, përmes postës paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN125-0259 të datës 26 nëntor 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, në shumë prej 72,014.90 euro, nga NSH "BANKKOS" (në likuidim), me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar prova që me veprimin e AKP-së i është ndërprerë marrëdhënia e punës. AKP-ja konstaton se në bazë të deklaratës së paditësit, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 1990, ndërsa ndaj NSH-së ka filluar procedura e likuidimit me 17 korrik 2013. Andaj si rrjedhojë e kësaj nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së.

Paditësi në ankesë pohon se arsyetimi i dhënë në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit është i gabuar dhe se nuk mund të konsiderohet se kërkesa është e pa bazuar. Tutje ai pohon se pas publikimit të njoftimit nga ana e AKP-së në shtypin ditor "Koha Ditore" me datë 05.08.2014, të gjitha kreditorët e kësaj Banke kemi paraqit kërkesës të afatshme për kompensimin e pagave për periudhën prej vitit 1990 e deri në vitin 1999. Tutje ai pohon se nuk kishte fuqi ligjore të i realizoj të drejtat e veta nga marrëdhënia e punës për shkak masa të dhunshme të aplikuara në këtë NSH. Ai pohon se Banka Popullore e Jugosllavisë me Aktvendimin për plotësimin e kushteve për hapjen e procedurës se falimentimit të Bankës së Bashkuar të Kosovës me datë 03 tetor 1990, ka propozuar fillimin e hapjes se procedurës se falimentimit. Pastaj Gjykata Ekonomike e Qarkut në Beograd me Aktvendimin ST207/90 të datës 13.12.1990, ka nxjerr Aktvendimin me të cilin ka filluar procedura e falimentimit të Bankës së Bashkuar të Kosovës SH.A nga Prishtina. Ai pohon se për shkak të këtyre procedurave nuk ka pasur mundësi të godas vendimin për fillimin e procedurës se falimentimit, dhe me këtë nuk ka pasur mundësi as të realizoj të drejtat e veta nga marrëdhënia e punës. Bashkë me ankesë paditësi ka bashkangjitur vendimin e ankimuar të Autoriteti të Likuidimit, PRN125-0259 të datës 26 nëntor 2014.

Me datë 12 prill 2004, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshuar një urdhër për paditësin me të cilin ka kërkuar që të dorëzohen prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 25 prill 2024, paditësi e dorëzoi në DHPGJ-së një parashtresë dhe përgjigjet në urdhër. Më këtë parashtresë ai ka dorëzuar një listë të punëtoreve të vitit 1990,

kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 31 dhjetor 1990, një Aktvendim për themelim të marrëdhënies së punës të datës 20 shtator 1983, një Aktvendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 27 dhjetor 1990, dhe kopjen e letërnjoftimit.

Me datë 23 maj 2024, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale.

AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të theksoi në ankesë se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se ky Vendim nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore, prandaj nuk ka bazë të shfuqizohet. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa për ndërprerje të parakohshme të kontratës se punës është e pa vlefshme pasi që nuk ka prova që me veprimin e AKP-së paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, andaj i njëjti nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së që të i njihet kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës se punës.

Me datë 11 qershor 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-7495 e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi nuk ka bashkangjitur asnjë provë me ankesën e tij për të mbështetur pretendimin për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës se punës në shume prej 72,014.90 euro nga NSH "Banka Themelore e Kosovës" në likuidim. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi marrëdhënien e punës i është ndërprerë në vitin 1990, shume vite me herët para se NSH-ja të privatizohet në vitin 2013. Andaj nga këto arsye, paditësi nuk gëzon të drejtën të i njihet e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës se punës në shume prej 72,014.90 euro, në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Me datë 15 korrik 2024, paditësi për mes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër Aktgjykimin të Shkallës së I-rë të DHPGS, C-IV-14-7495 të datës 11 qershor 2024 për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar duke e detyruar të paditurën të paguaj shumën

prej 72,014.90 euro. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se tek Autoriteti i Likuidimit ka paraqitur kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës se punës prej 72,014.90 euro, e cila pa ndonjë bazë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit. Tutje paditësi pohon se edhe Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar ankesën duke vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit pa ndonjë bazë ligjore. Tutje ai pohon se Gjykata nuk e ka marrë për bazë faktin se paditësi ishte në punë në NSH deri në privatizim dhe për këtë kishte prova të mjaftueshme të bashkangjitur me ankesë të datës 15 dhjetor 2014. Paditësi pretendon se Gjykata nuk ka vërtetuar drejtë dhe sakte gjendjen faktike dhe me këtë ka shkelur rregullat procedurale pasi që ajo nuk ka shqyrtuar dhe as marrë për bazë provat e paraqitura. Ai konsideron se Aktgjykimi është i pa ligjshëm pasi që në bazë të urdhëresës administrative nr.2005/15 punëtorët mund të marrin pjesë në 20% të aksioneve, nëse ata janë të regjistruar si punëtor të NSH-së në kohën e privatizimit. Bashkë me këtë ankesë ai dërgon të njëjtat dokumente të cilat i kishte dorëzuar edhe në shkallën e parë.

Me datë 26 gusht 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankese. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 05 gusht 2014, e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nga NSH "Banka Themelore e Kosovës" (në likuidim) në shumë prej 72,014.90 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar prova që me veprimin e AKP-së atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës. AKP-ja konstaton se në bazë të deklaratës së paditësit, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 1990, ndërsa ndaj NSH-së ka filluar procedura e likuidimit me 17 korrik 2013. Andaj si rrjedhojë e kësaj, paditësit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar ankesën dhe e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me të njëjtën bazë ligjore.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallen e I-rë me datë 15 dhjetor 2014, ai kërkon pagat e pa paguara nga NSH "Banka Themelore e Kosovës" për periudhën nga vitin 1990 e deri në vitin 1999 në shume prej 72,014.90 euro. Me këtë ankesë ai ka bashkangjitur një listë të punëtoreve të vitit 1990, kopjen e Librezës së Punës e mbyllur me 31 dhjetor 1990, një Aktvendim për themelim të marrëdhënies së punës të datës 20 shtator 1983, një Aktvendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 27 dhjetor 1990, dhe kopjen e letërnjoftimit.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka trajtuar me Aktgjykimin e ankimuar kërkesën e paditësit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, e cila kërkesë ishte objekt i vendimit të Autoritetit të Likuidimit, të bashkangjitur me këtë ankesë. Shkalla e I-rë ka konstatuar se me të drejtë se paditësi nuk ka dorëzuar prova për të vërtetuar se me veprimin e AKP-së, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës në NSH, duke konstatuar se marrëdhënia e punës paditësit i është ndërprerë në vitin 1990, ndërsa NSH ka hyre në likuidimin në vitin 2013.

Paditësi me ankesën në Shkallen e I-rë ai ka dorëzuar ai ka bashkangjitur një listë të punëtoreve të vitit 1990, kopjen e Librezës së Punës e mbyllur me 31 dhjetor 1990, një Aktvendim për themelim të marrëdhënies së punës të datës 20 shtator 1983, një Aktvendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 27 dhjetor 1990, dhe kopjen e letërnjoftimit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallen e II-rë ai ka dorëzuar të njëjtat dokumente të dorëzuara edhe në Shkallën e I-rë. Këto prova nuk janë relevante për kërkesën e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, meqë asnjëra nga ato prova nuk e vërtetojnë faktin se paditësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së, e cila ka hyre në likuidim me datë 16 qershor 2014.

Për më tepër nga kopje e Librezës së Punës të cilën paditësi e sjell me ankesë shihet se ajo është mbyllur 31 dhjetor 1990, do të thotë shume vite me herët para se të fillon procedura e likuidimit ndaj NSH-së.

Paditësit është e qartë se me veprimin e AKP-së për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH-së, nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Prandaj nga arsyet e cekura, paditësit nuk mund të i njihet e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, pasi që nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Nga këto arsye ankesa, e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore:**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 30 euro me datë 05 gusht 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë për procedurën ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 29 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues \_\_\_\_\_